- a) Shumen e cila sipas opinionit të tij duhet ti paguhet sipas kontratës; dhe
- b) pas evidentimit të shumave të paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund të jete rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumën përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

Neni 30 Shkaqet për kompensim

30.1 Shkaqet për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa tjera për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFECTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose te riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimit i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jete të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkritazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dënuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimit përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga

autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuar në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- (a) Kontraktuesi ndërpre në punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- (b) Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- (c) Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- (d) Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- (e) Menaxheri i Projektit njofton se mos korigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- (f) Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e Punëve për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur cilado nga palët kontraktuese njofton Menaxherin e Projektit për shkelje të kontratës për arsye të tjera nga ato të renditura më lart nën 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë a është shkelja thelbësore apo jo.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesit do të përfundoj vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Paguesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë mbi vlerën e punës së përfunduar dhe materialet e porositura me më pak se përqindja e cila kërkohet nga vlera e punëve të përfunduara, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhësimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATËS kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë: Gjuha Shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është: 10% të vlerës së kontratës, për kohëzgjatjen e periudhës prej: 24 muaj + 30 ditë, nga data e nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	<p>Shuma minimale e sigurimit do të jetë:</p> <p>(a) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë e tyre, Impianteve dhe Materialeve gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definiuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, sëbashku me materialin dhe impiantin gjer në kosoton e zëvendësimit të plotë;</p> <p>(b) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre;</p> <p>(c) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është: 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar;</p> <p>(d) Ndëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar, (ii) të personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar,</p>
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët Brenda 5 ditëve kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditëve kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë nga dita e caktuar në planin e menaxhimit nga menaxheri i projektit.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë: Sipas Dinamikës së punëve.

Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë: 0.25 % e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është: 10 % e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në Vend – Punishte nga ana e Kontraktuesit.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Inspektimi dhe testimi behet konform kushteve te përgjithshme te kontratës. Menaxheri i Projektit caktohet me vendim nga Z.K.A – ja.
Pagesat	24.1	Pagesat do të bëhen në Euro. Autoriteti Kontraktues do ti paguaj kontraktuesit vlerën e kontraktuar në situacion.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: Nuk aplikohet.
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% të vlerës së kontratës (me sigurim ekzekutimi).
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 5 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësi mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është [shëno numrin] ditë
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë se Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin në Kosovë.

Paramasa dhe Paralogaria

Shkolla "Nesimi Elshani" në Nagavc Oborri i shkollës, fusha e sportit

Verejtje: Kontraktori duhet patjetër t'iu referohet Specifikimeve Gjenerale dhe detaleve. Çmimet duhet të përfshijnë furnizimin, transportin dhe instalimin/finalizimin e të gjitha materialeve. Kontraktori duhet të dorëzojë Deklaratat e Konformitetit për të gjitha materialet e përdorura në këtë projekt. Për të gjitha punët e ekzekutuara, patjetër duhet të bëhen testet paraprake.

1. PUNËT PREGADITORE					
POS	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.1	Pas përfundimit të punimeve duhet të largohen dhe të bëhet pastrimi i objektit si dhe terreni për rreth objektit.	Komplet	1.00	5.00	5.00
Gjithsej POS 1:					5.00
2. PUNËT E FUSHA E SPORTIT					
POS.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
2.1	Mobilizimi i ndërmarrjes, Rethimi i punishtes për ekzekutimin e punimeve në Pastrimin e dheut dhe ndërtimin e Fushës sportive.	Komplet	1	5.00	5.00
2.2	Gërmimi, ngarkimi, bartja në deponi të qytetit në largësi 3km' dhe shkarkimi i dheut të kategorisë së III dhe IV-të.	m ³	148	0.50	74.00
2.3	Furnizimi transporti me gure të fraksionit Fr:(0-125)mm', gjatë shtruarjes të bëhet ngjeshja e zhavorit për mos shafitjes si dhe nivelizimi i bazës së fushës.	m ³	148	4.00	592.00
2.4	Nivelizimi si dhe ngjeshja e bazës së fushës në tërë sipërfaqe si dhe mbushja me zhavore të fraksionit Fr:(0-32)mm' me trashësi t=(15-20)cm' para se të bëhet shtruarja e Asfaltit.	m ³	148	5.00	740.00
2.5	Furnizim, transporti si dhe shtruarja e asfaltit "A8 - 11" me trashësi mesatare t=7cm' gjatë shtruarjes së asfaltit të bëhet edhe ngjeshja dhe nivelizimi i tij. Gjatë shtruarjes së asfaltit duhet të lpet ramje terthore dhe gjatsore për largimin e ujerave atmosferike.	m ²	740	8.00	5,920.00
2.6	Furnizimi transporti si dhe vendosja e portave të futbollit të vogël në fushë. Në këto pozicione duhet të përfshihen të gjitha punët paraprake për vendosjen e portave.	cope	2	150.00	300.00
2.7	Furnizimi transporti si dhe vendosja e Koshave për basketboll në fushë. Në këto pozicione duhet të përfshihen të gjitha punët paraprake për vendosjen e Koshave.	cope	2	160.00	320.00
2.8	Furnizimi transporti si dhe punimi i vijave për futboll të vogël si dhe për basketboll në pjesën e fushës së shtruar me asfalt	komplet	1	160.00	160.00
Gjithsej POS 2:					8,111.00
3. PUNËT E OBORIT					
POS.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
3.1	Gërmimi, ngarkimi si dhe transporti i dheut të kategorisë së VI dhe VII-të për shtruarjen e kubzave në oborin e shkollës	m ³	85	0.35	29.75
3.2	Furnizimi transporti dhe shtruarja e zhavorit të fraksionit Fr:(0-32)mm' nën bazën me trashësi t=20cm'.	m ³	28	5.00	140.00

3.3	Furnizimi transporti dhe shtruarja e zhavorit të fraksionit Fr:(4-8)mm' nën bazën me trashësi t=8cm'.	m ²	5	5.00	25.00
3.4	Furnizimi transporti si dhe punimi i anesoreve me dim: 20x10x100cm', përgjat trotuarit si dhe ne oborin para shkolles gjatë vendosjes se anësoreve duhet pë përfshihen të gjitha punët paraprake si vetonimi, nivelizimi etj.	m'	140	6.00	840.00
3.5	Furnizimi ,transport si dhe shtruarja e kubëzave me trashësi t=8cm' të klases C-30/37. pasi që të shtrohen duhet të bëhet mbushja e fugave me rrere të imet .	m ²	50	5.50	275.00
3.6	Gërmimi i gropave për vendosjen e dheut për drunjet dekorativë dimensionet e hapjes janë 60x60x50cm'. Dheu i tepërt duhet të ngarkohet si dhe të deponohet në deponi të qytetit.si dhe furnizimi me dheun e pershtatashen per mbielljen e bimeve dekorativë.	copë	12	0.30	3.60
3.7	Furnizimi transporti si dhe vendosjen e dheut të përshtatshëm për drunjet dekorativë CATALPA .dimensionet e gropave janë 60x60x50cm'.	copë	12	1.00	12.00
3.8	Furnizimi transporti si dhe mbjellja e drunjëve dekorativë CATALPA moshë e tyre duhet të jetë minimum tre vjeqare para mbielljes.	copë	12	13.00	156.00
3.9	Furnizimi ,transport me material si dhe shtruarja e iberçukut ne pjesen e hyrjes se objektit trashësia e iberçukut t=8cm' , gjate shtruarje duhet te lihet ramje ka oborri i objekti per shkak te largimit te ujerave atmosferike	m ²	64	4.00	256.00
Gjithsej POS 3:					1,737.35
POS.	4. PUNET E RRETHOJES				
4	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
4	Konstruksioni i rrethojës h=2m				
4.1	Furnizimi dhe punimi i konstruksionit te shtyllave te te zingtuara fi 60mm *3mm ne distance ne mes te shtyllave max 3m ne skaje te këndeve te behet shtangimi me profile te njejta.Shtyllat vertikale ne këndet janë 68mm*3mm.Tegjitha shtyllat janë mbyllura me kapak alumini. Në çmim të llogaritet edhe vendosja (betonimi) i konstruksionit të rrethojës.	cope	30	15.00	450.00
4.2	Furnizimi dhe vendosja e rjetës se zinkuar metalike me lartësi h=2m me dim(50*50*3.0*6000)mm (rrjeta duhet te jete e pa ndërprere).	m ²	180	2.00	360.00
4.3	Mbështjellja e rjetës me tel inox 0.5m ne pjesën e sipërme te rjetës	m'	90	0.50	45.00
4.4	Furnizimi dhe vendosja e telit inox fi 3mm ne distance çdo 30cm deri ne lartësi 1m,kurse ne lartësi mbi 1m çdo 50cm	m'	90	0.80	72.00
4.5	Montimi i kapëseve speciale ne mes te rrjete dhe telit inox kapëse te inoxit me dim 8-10mm	m ²	200	0.50	100.00
4.6	Montimi i derës hyrëse me gypa 5/4 e mbyllur me rrjete te telit te zinkuar me dim 400*200 cm dera duhet te ketë bravën e duhur për mbyllje	cope	1	350.00	350.00
4.7	Furnizimi transporti dhe montimi i rrethojës metalik ne nje pjese te oborrit te shkolle, në të cilën egzistojnë shputat dhe shtyllat e betonit. Rrethoja metalike duhet te punohet prej profileve metalike, te behet lyerja me ngjyre antikoruaduese si dhe me ngjyrë të zezë, si dhe te behet inkastrimi i saj ne shputa te betonit. Ky pozicion te punohet sipas standardeve. Për të gjitha pozicionet paraprakisht të bëhet matja në vend. Forma dhe dimensionet e rrethojës të përzgjidhen nga menagjeri i projektit.	cope	28	25.00	700.00

4.8	Montimi i derës hyrëse me profila qeliku me dim 260*200 cm dera duhet te ketë bravën e duhur për mbyllje.	cope	1	160.00	160.00
4.9	Montimi i derës hyrëse me profila qeliku me dim 100*200 cm dera duhet te ketë bravën e duhur për mbyllje.	cope	1	100.00	100.00
Gjithsej POS 4:					2,337.00
I. REKAPITULIMI I PUNËVE					
1	PUNËT PREGADITORE				5.00 €
2	PUNËT TE FUSHA E SPORTIT				8,111.00 €
3	PUNËT E OBORRIT				1,737.35 €
4	PUNET E RRETHOJES				2,337.00 €
Gjithësejt:					12,190.35 €
TVSH					Tvsh e llogaritur ne poz
Gjithësejt me TVSH					12,190.35 €

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

RIPARIMI I SHKOLLAVE NE KOMUNEN E RAHOVECIT

SHKOLLA FILLORE "31 Marsi" në fshatin GURI I KUQ

I PUNET E FUSHES SE SPORTIT

Nr.	Pozicioni	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Mobilizimi i ndërmarjes , Rethimi i punishtes për ekzekutimin e punimeve në Pastrimin e dheut dhe ndërtimin e Fushës sportive.	Komplet	1	5.00	5.00
2	Gërmimi , ngarkimi , bartja në deponi të qytetit në largësi 3km' dhe shkarkimi i dheut të kategoris së III dhe IV-të .	m ³	148	0.40	59.20
3	Furnizimi transporti me gure të fraksionit Fr:(0-125)mm' , gjatë shtruarjes të bëhet ngjeshja e zhavorit per mos shafitjes si dhe nivelizimi i bazës së fushës.	m ²	148	4.00	592.00
4	Nivellizimi si dhe ngjeshja e bazës së fushës në tërë sipërfaqe si dhe mbushja me zhavore të fraksionit Fr:(0-32)mm' me trashesi t=(15-20)cm' para se te bëhet shtruarja e Asfaltit.	m ²	148	5.00	740.00
5	Furnizim, transporti si dhe shtruarja e asfaltit "AB-11" me trashesi mesatare t=7cm' gjate shtruarjes së asfaltit të bëhet edhe ngjeshja dhe nivelizimi i tij.gjate shtruarjes se asfalti duhet ti ipet ramje terthore dhe gjatsore per largimin e ujerave atmosferike.	m ²	740	7.80	5,772.00
6	Furnizimi transporti si dhe vendosja e portave te futbollit te vogel ne fushe. Ne kete pozicione duhet te perfshihen te gjitha punet paraprake per vendosjen e portave.	cope	2	150.00	300.00
7	Furnizimi transporti si dhe vendosja e Koshave pe basketboll ne fushe. Ne kete pozicione duhet te perfshihen te gjitha punet paraprake per vendosjen e Koshave.	cope	2	280.00	560.00
8	Furnizimi transporti si dhe punimi i vijave per futboll te vogel si dhe per basketboll ne pjesen e fushes se shtruar me asfalt	komplet	1	180.00	180.00
Totali :					8,208.20

Nr.	Pershkrimi i puneve	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Punet pergaditore				
1.1	Demolimi i linoleumit dhe iberkukut ne koridorin qendror te shkolles si dhe ne klasen e III .Ne oferte te llogaritet edhe transporti i materialit deri ne deponine per materiale te ngurta legale.	komplet	1	50.00	50.00
2	Punet e dyshemese				
2.1	Furnizimi me material si dhe punimi i iberkukut te punohet dy shtresa styropor 3cm N4 si dhe rere e perzier me cemento ne trashesi duke ju pershtatur nivelit paraprak, jo te krijohen disnivele me hapesirat tiera .	m ²	172	3.50	602.00

2.2	Furnizimi me material si dhe shtruarja e linoleumit ne klasen e III ,linoleumi te punohet me ngjites adekuat ku duhet te shtrihet mire ,ngjyra(e gjelber) duhet pershtatet me klaset tjera si dhe te parashihet kendorja ne perimetrin e klases	m ²	48	4.50	216.00
2.3	Furnizimi me material si dhe punimi i qeramikes ne koridorin qendror te shkolles ,qeramikat duhet te jene te kualitetit të mirë nga porcelani me dimensione 40x40 me ngjyr Kremë, mos te jene te rreshqitshme dhe paraprakisht duhet te konsultohet organi mbikqyres pastaj te behet montimi i tyre ,ngjitesu duhet te jete adekuat dhe fuga duhet t'i pershtatet ngjyres se qeramikes.	m ²	125	13.00	1,625.00
Totali :					2,493.00

REKAPITULIMI		
1	PUNET E FUSHES SE SPORTIT	8,208.20
2	PUNET E DYSHEMESË	2,493.00
TOTALI:		10,701.20
TVSH:		Tvsh e llogaritur ne poz
TOTALI ME TVSH:		10,701.20

PARAMASA DHE PARALLOGARIA
MEREMETIMI I SHKOLLAVE NE KOMUNEN E RAHOVECIT

Shkolla "Dëshmorët e Zatriqit" në Zatriq

PUNET E FUSHES SE FUTBOLLIT

Nr.	Përshkrimi i punës dhe materialit	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
I Punë Pregaditore					
1	Kontrollimi dhe ruajtja e instalimeve nëntoksore gjatë fazës së realizimit të punëve.	m ²	600	0.01	6.00
2	Shenjëzimi i trases dhe percjellja e punimeve me instrument gjeodezik.	m ²	600	0.01	6.00
Gjithëj:					12.00

Nr.	Përshkrimi i punës dhe materialit	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
II Punë Tokësore					
1	I hyerja, Gërmimi, ngarkimi dhe transporti i betonave në oborin e shkollës si dhe të bëhet transporti në deponi i betoneve të tepert, të transportohet në deponi ku e cakton organi mbikqyrës në largësi deri në 5 km'	m ³	220	0.20	44.00
2	Gërmimi, ngarkimi dhe transporti i dheut të kategoris së VI dhe VII-të në oborin e shkollës, si dhe të bëhet transporti në deponi ku e cakton organi mbikqyrës në largësi deri në 5 km'	m ³	1636.25	0.55	899.94
3	Furnizimi, transporti, shtruarja dhe ngjeshja e zhavorit të fraksionit Fr:(0-63)mm' shtruarja të behet me trashësi t=15cm'.	m ³	99	4.00	396.00
4	Furnizimi, transporti, shtruarja dhe ngjeshja e zhavorit të fraksionit Fr:(0-32)mm' shtruarja të behet me trashësi t=15cm'.	m ³	99	5.00	495.00
5	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rrerës të fraksionit Fr:(4-8)mm' nën bazen e kubzave	m ³	33	5.00	165.00
Gjithëj:					1,999.94

Nr.	Përshkrimi i punës dhe materialit	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
III Punë Montuese					
1	Furnizimi, transporti si dhe punimi i anesoreve nga betoni i armuar MB30 me dimensione 10x20x100cm' gjatë shtuarjes të behet nivelizimi i tyre si dhe të behet mbuashe nën bazen si dhe anes tyre me beton të varfer.	m ³	176	6.00	1,056.00
2	Furnizimi, transporti si dhe punimi i kubzave nga betoni i armuar MB30 me dimensione 10x20x8cm' gjatë shtuarjes të behet nivelizimi i tyre si dhe të behet mbuashe e fugave me rrere të imet.	m ²	55	7.00	385.00
3	Furnizimi, transporti si dhe shtrirja e asfaltit në fushen e futbollit me trashësi t=7cm'	m ²	600	8.00	4,800.00
4	Furnizimi, transporti si dhe vendosja e dy golave për futboll të vogël, duhet të jenë nga profilet e hekurit.	cope	2	170.00	340.00
5	Furnizimi, transporti si dhe vendosja e dy koshave për basketboll, të cilët duhet të jenë sipas standardeve.	cope	2	250.00	500.00
Gjithëj:					7,081.00

Rekapitulimi

1	Punë Pregaditore				12.00
2	Punë Tokësore				1,999.94
3	Punë Montuese				7,081.00
Totali:					9,092.94

PUNET E MEREMETIMI DHE PUNIMI KULMIT

Nr.	Përshkrimi i punës dhe materialit	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
I	Punë Pregaditore				
1	Kontrollimi dhe ruajtja e instalimeve të ndryshme në pilafora si dhe në muret e klasave gjatë fazës së realizimit të punëve.	m ²	16	0.01	0.16
Gjithëj:					0.16

Nr.	Përshkrimi i punës dhe materialit	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
II	Punë e Demolimit				
1	Demolimi i llajsneve përth pilaforit në klasat e shkolles si dhe deponimi i tyre në deponi	m ²	13.2	0.10	1.32
2	Demolimi i konstruksionit të kulmit ekzistues, nga materiali merter, drasë listela si dhe tjegulla, materiali i tubuar duhet të ngarkohet si dhe të deponohet në deponi të qytetit në çmim llogaritur të gjitha punët paraprake për demolimin e pjesë për zgjerime	m ²	13.2	0.50	6.60
3	Thyerja e betoneve para hyrjes së objekti në pjesën e terasës ekzistuese, materiali i tubuar duhet të ndgarkohet si dhe të deponohet në deponi të qytetit	m ²	4.95	2.00	9.90
4	Prerja e asfaltit si dhe thyerja e betoneve para hyrjes së objekti në pjesën e terasës ekzistuese, materiali i tubuar duhet të ngarkohet si dhe të deponohet në deponi të qytetit	m ²	4.34	2.00	8.68
5	Demolimi i ollugeve horizontale si dhe vertikale	m'	8.25	0.15	1.24
Gjithëj:					27.74

Nr.	Përshkrimi i punës dhe materialit	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
IV	Punë e ANEKSIT				
1	Thyerja si dhe vendosja e ankerave në murin ekzistues për forcimin e konstruksionit të kulmit në këto pozicione duhet të përfshihen të gjitha punët paraprake si dhe pjesa e demtuar të kethehet në gjendje të mirë.	m'	7.7	0.15	1.16
2	Furnizimi transporti si dhe vuarja në veper e e brinakeve për konstruksionin e kulmit me dimensione 4.5x7.5m ² .	m ²	22	2.50	55.00
3	Furnizimi transporti si dhe vendosja në veper e bjinjeve të konstruksionit të kulmit	m ²	22	3.00	66.00
4	Furnizimi transporti si dhe vuarja në veper e drasave me trashësi t=2.0 cm' në konstruksionin e kulmit.	m ²	22	2.90	63.80
5	Furnizimi transporti si dhe vuarja në veper e kontraktiveve në konstruksionin e kulmit.	m ²	20	0.25	5.00
6	Furnizimi transporti si dhe vuarja në veper e listelave me prerje tërthore 3x5cm' në konstruksionin e kulmit	m ²	22	0.40	8.80
7	Furnizimi transporti si dhe shatërvimi me gletë në gjatë shtrirjet të vendoset rrjeta adekuate në Muret dhe pilafora si dhe në fund të behet rafshimi i tij për parapregaditjen për ngjyrosje.	m ²	65.78	3.20	210.50

8	Furnizimi transporti si dhe meremetimi i qosheve ndermjet pllafoneve si dhe mureve ,gjate meremetimit duhete te vendoset rrjeta si dhe materiali mbushes .	m'	17.6	0.10	1.76
9	Furnizimi transporti si dhe ngjyrosja e Mureve dhe pllafoneve me baze si dhe dy shtresa ngjyre te polikolorit.	m ²	47.3	0.40	18.92
10	Furnizimi transporti si dhe ngjyrosja e mureve me baze si dhe dy shtresa ngjyre te polikoloret.	m ²	18.48	0.30	5.54
11	Frunizimi transporti si dhe vuarja ne veper e tjegullave ne siperfaqen e konstruksionin e kulmit	m ²	24.2	6.80	164.56
12	Frunizimi transporti si dhe vendosja e olluqeve horizontal si dhe vertikal ne qmim duhet te perfshihen te gjitha punet paraprake si lidhjet etj.	m'	33.88	4.700	159.24
13	Frunizimi transporti si dhe Punimi i themeleve si dhe pllakes me trashesi t=18cm' nga betoni MB 30.	m ³	7.15	55.000	393.25
14	Frunizimi transporti si dhe Punimi i mureve nga bilokat e argjiles me trashe t=25cm' ne qmim llogaritet te gjitha punet paraprake . Si punimi i llaqit pune dore etj.	m ³	26.48	10.000	264.80
15	Frunizimi transporti si dhe Punimi i Pllakes se meskati FERT ne qmim perfshihen te gjitha punet paraprake .	m ²	23.76	10.000	237.60
16	Frunizimi transporti si dhe Punimi i lakimi i armature fi 12, fi 10,fi8.	kg	616	0.480	295.68
17	Furnizimi transporti si dhe montimi i dyerve PVC me dimensione 2.2x2.6m dyert duhet te jene me dy krahet per hapje si dhe ne pjesen e sipërme nje dritare me kiper trashesia e profileve duhet te jet t=8cm' te perforcuara me profile adekuate ne pjesen e kraheve per hapje duhet te punohet nje pjes e poshtme me panella plastike si dhe ne pjesen e sipërme me dritare te vogla statike ..	cope	1	260.00	260.00
18	Furnizimi transporti si dhe montimi i Dritareve PVC me dimensione 2,4x1,6m dritare duhet te jene me tri krahet per trashesia e profileve duhet te jet t=8cm' te perforcuara me profile adekuate .	cope	1	200.00	200.00
19	Frunizimi transporti , vendosja e skeleve si dhe punimi fasades me stiropore t=8cm' duke perfshire te gjitha punet paraprake si ngjitesi stropori , rrjeta , kendet , fasada , ngjyra etj.	m ²	43.56	12.00	522.72
20	Frunizimi transporti , vendosja e skeleve si dhe punimi i kallkanave ne knauf per lageshti si dhe mbushja e fugave te tyre me rrjet ,material te fuges , ljerja me baze si dhe punimi i fasades me trashen e kokres 1.5mm' si dhe ne fund te behet ngjyrosja e saj me ngjyre te pershtatshe , ne çmim llogariten meterkatror e jo ne meter gjatesi pasi qe kallkane kane edhe qoshe .	m ²	44	14.00	616.00
Gjithej:					3,550.32

Rekapitulimi	
1 Punë Pregaditore	0.16
2 Punë Pllafonit	27.74
3 Punet e Kulmit	3,550.32
Totali:	3,578.22

PUNET E DYSHEMESE

Nr.	Përshkrimi i punës dhe materialit	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
II	Punë Tokësore				
1	Furnizimi transporti si dhe shtrirja e estriut ne klaset e nxenesve si dhe ne zyre , para shtrirjes se estriut te behet shtrirja e najlonit se pari , shtrirja e stroporit me trashesi t=3cm' N4 ,siper stroporit te vendose edhe nje shtres najloni si dhe si shtres finale te vendose estrl me materia qimento zall me trashesi mesatare t=5cm' ne tere siperfaqen si dhe te behet rrafshimll i tij.	m ²	13.2	4.000	52.80
2	Furnizimi transporti si dhe punimi i pllakave te qeramikes ne bazamentin e koridorit si dhe shkallët. Pllakat duhet te jene jo te reshqitshme si dhe me trashesi t=8mm' ne çmime llogariten te gjitha punet paraprake .	m ²	24.2	15.000	363.00
3	Furnizimi transporti si dhe vendosja e bazamakeve nga graniti natyrale , graniti duhet te jete i perpunuar si dhe ti punohen pikoret.	m ²	0.58	40.000	23.20
Gjithej:					439.00

REKAPITUIMI PER DYSHEME

1 Punë Tokësore	439.00
Totali:	439.00

REKAPITULIMI

I	PUNET E RREGULLIMIT TE OBORIT	9,092.94
II	PUNET E MEREMETIMI DHE PUNIMI KULMIT	3,578.22
III	PUNET E DYSHEMESE	439.00
TOTALI		13,110.16
TVSH:		Tvsh e llogaritur ne poz
TOTALI ME TVSH:		13,110.16

Shkolla "4 Dëshmorët" në Ratkoc
Rregullimi i banjove, dyer për klasa dhe banjo

Verejtje: Kontraktori duhet patjetër t'iu referohet Specifikimeve Gjenerale dhe detaleve. Cmimet duhet të përfshijnë furnizimin, transportin dhe instalimin/finalizimin e të gjitha materialeve. Kontraktori duhet të dorëzojë Deklaratat e Konformitetit për të gjitha materialet e përdorura në këtë projekt. Për të gjitha punët e ekzekutuara, patjetër duhet të bëhen testet paraprake.

POS	1. PUNËT PREGADITORE				
1	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.1	Pas përfundimit të punimeve duhet të largohen të gjitha mbeturinat dhe të bëhet pastrimi i objektit të shkollës si mbrenda ashtu edhe jashtë.	Komplet	1.00	5.00 €	5.00
Gjithsej POS 1:					5.00
POS	2. PUNËT DEMOLUSE				
2	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
